| 16 | 26_018 | Testimi i vajit për tre tansfomatoret energjetik | 23.02.2026 | 4,000.00 € | 03.03.2026 | 19.03.2026 | 3,492.80 € | OE: P.P.S-M | **KONTRAKTUAR!** |
| 17 | 26_019 | Rehabilitimi i pompave në SP Samadregje | 16.02.2026 | 10,000.00 € | 12.03.2026 | / | / | / | **Në proces vleresimi!** |
| 18 | 26_022 | Furnizim me material teknik për puntorinë elektrike dhe mekanike në Shkabaj | 24.02.2026 | 12,0000.00 € | 18.03.2026 | / | / | / | **Në proces vlerësimi!** |
| | | Furnizimi dhe montimi me pompe të ujit për Skip Hidromek 102B dhe bateri për | | | | | | | **Anuluar, asnje oferte e pranuar!** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | 26-023 | kamionetën Renault Master. | 02.03.2026 | 03.03.2026 | 650.00 € | / | / | / | |
| 20 | 26-025 | Furnizim me pajisje të rrjetave (router dhe switch) profesional për siguri kibernetike dhe komunikim. | 05.03.2026 | 17,000.00 € | 26.03.2026 | / | / | / | Në proces vleresimi! |
| 21 | 26-026 | Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH | 05.03.2026 | 2,000.00 € | 12.03.2026 | / | / | / | Në proces vleresimi! |
| 22 | 26-002 | Mirembajtja vjetore e SP've dhe ON've (pjesa elektrike, makinerike dhe hidrualike) – RITENDER. | 09.03.2026 | 17,000.00 € | 31.03.2026 | / | / | / | Në proces vleresimi! |
| 23 | 26-024 | Furnizim me vajra dhe yndyrna për SP dhe ON | 10.03.2026 | 5,000.00 € | 17.03.2026 | / | / | / | Anuluar, asnje oferte e pranuar! |
| 24 | 26-008 | Rehabilitimi Elektro - makinerike i 4 stacioneve Pompike në Nj.P. Komoran - RITENDER | 09.03.2026 | 25,000.00 € | 31.03.2026 | / | / | / | Në proces vleresimi! |
| 25 | 26-028 | Furnizim me mjete mbrojtëse në punë | 12.03.2026 | 35,000..00 € | 04.04.2026 | / | / | / | Në proces! |
| 26 | 26-021 | Furnizim me vaj të turbinës dhe transformatorit për HC | 16.03.2026 | 10,000.00 | 08.04.2026 | / | / | / | Në proces! |
| 27 | 26-030 | Furnizim me material zyrtar | 13.03.2026 | 7,150.00 € | 24.03.2026 | / | / | / | Në proces vlerësimi! |
| 28 | 26-029 | Funksionalizimi i zyrave të Njësisë për Mirëmbajtjen e Digave dhe Infrastrukturës | 19.03.2026 | 10,000.00€ | 10.04.2026 | / | / | / | Në proces! |
| 29 | 26-032 | Furnizimi, instalimi dhe lidhja e agregateve dizel | 24.03.2026 | 4,000.0 € | 03.04.2026 | / | / | / | Në proces! |
| 30 | 26-024 | Furnizim me vajra dhe yndyrna për SP dhe ON - Retender | 25.03.2026 | 5,000.00 € | 02.04.2026 | / | / | / | Në proces! |

## 2.5. Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta

Gjatë tremujorit të **parë të vitit 2026-TM1**, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka realizuar një volum të konsiderueshëm aktivitetesh në funksion të mbështetjes administrative, ligjore dhe operacionale të ndërmarrjes. Aktivitetet janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe të koordinuar, duke siguruar funksionim të rregullt të proceseve të brendshme dhe përmbushje të obligimeve institucionale dhe ligjore.

Në fushën e burimeve njerëzore janë menaxhuar procese të shumta administrative që lidhen me marrëdhëniet e punës, përfshirë lëshimin e vërtetimeve, vendimeve për pushime vjetore dhe pa pagesë, si dhe administrimin e pushimeve mjekësore. Kanë bërë regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha të dhënave të pushimeve në sistemin elektronik të menaxhimit të stafit. Janë trajtuar kërkesat për trajnime, është përgatitur raporti për sigurimin shëndetësor të punëtorëve dhe familjarëve të tyre, si dhe është realizuar përzgjedhja e punëtorit të dalluar për vitin 2025.

Në kuadër të proceseve të rekrutimit, është menaxhuar konkursi për punëtorët sezonal 2026, përfshirë shpalljen publike, administrimin e aplikimeve, vlerësimin e kandidatëve dhe vendimmarrjen për fazat përkatëse të procesit. Procesi i rekrutimit për pozitën "Operues në Stacione Pompike" është përgatitur, duke përfshirë testimin me shkrim, intervistat, përgatitjen e procesverbaleve dhe finalizimin e vendimit për pranimin në punë të kandidatëve më të suksesshëm.

Në aspektin juridik, gjatë kësaj periudhe janë menaxhuar disa çështje gjyqësore në fusha të ndryshme si konteste pune, kompensim dëmi dhe lirim prone. Lëndët kanë qenë në faza të ndryshme procedurale, duke përfshirë pranimin e padive, dorëzimin e përgjigjeve në padi, mbajtjen e seancave gjyqësore dhe paraqitjen e qëndrimeve të palëve. Në disa raste janë administruar ekspertiza dhe janë bërë kundërshtime ligjore nga ana e ndërmarrjes, ndërsa në disa çështje seancat janë shtyrë ose janë caktuar data të reja për shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë departament kanë pranuar edhe një aktgjykim në favor të ndërmarrjes në një nga rastet e trajtuara. Paralelisht, janë përgatitur dhe dorëzuar dokumente të shumta për nevoja të auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), përfshirë kontrata pune, vendime për ngritje pagash, raporte vijueshmërie, lista të stafit të sistemuar dhe të pasistematizuar, dosje të plota të proceseve të rekrutimit për disa punëtor. Janë përgatitur edhe mostra dhe dokumentacione shtesë sipas kërkesave të auditorëve të jashtëm.

Sektori i IT-së ka siguruar funksionim të qëndrueshëm të sistemeve dhe ka realizuar aktivitete të përditshme dhe javore në drejtim të mirëmbajtjes së infrastrukturës teknologjike. Janë kryer përditësime të sistemeve, monitorim i vazhdueshëm i sigurisë, si dhe masa parandaluese për mbrojtjen nga rreziqet kibernetike. Drejtori i kësajë drejtorie ka ofruar mbështetje teknike për stafin dhe janë zhvilluar përmirësime në sistemet digjitale të menaxhimit të të dhënave, me fokus të veçantë në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së informacionit.

Shërbimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë ka vazhduar monitorimet e rregullta në njësitë punuese, duke siguruar zbatimin e standardeve të sigurisë dhe funksionimin e pajisjeve mbrojtëse, pa evidentim të parregullsive të theksuara gjatë kësaj periudhe.

**Përmbledhje**

Gjatë TM1 2026, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta ka treguar performancë të lartë në menaxhimin e proceseve administrative, ligjore dhe operative. Aktivitetet kanë qenë të shumta dhe të ndërlidhura, me fokus në përmirësimin e efikasitetit institucional, forcimin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin e suksesshëm të proceseve të rekrutimit dhe trajtimin aktiv të çështjeve gjyqësore dhe

kërkesave të auditimit. Departamenti ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin dhe funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

## 2.6. Departamenti Planifikim dhe Zhvillim

Në këtë departament gjatë tremujorit të parë **TM1**- 2026 janë realizuar këto aktivitete:

Nga arkiva kanë pranuar këto dokumente si në vijim:

- Kërkesë për inicimin e procedurës se prokurimit për projektin me titull: "Blerja e licensave për programe profesionale (AutoCad Civil 3D) me nr. 07-315 të datës: 03.02.2026
- Kërkesë për inicimin e procedurës se prokurimit për projektin me titull: "Blerja e licensave për programe profesionale (AutoCad) me nr.07-304 të datës: 02.02.2026
- Vendim mbi lejimin e punëve shtesë për kontratën me titull "Renovimi i objektit te drejtorisë – Ritender" me nr 02-316 të datës 03.02.2026.
- Kërkesë për inicimin e procedurës së prokurimit për projektin me titull: "Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH" me nr. 07-604 të datës: 04.03.2026
- Vendim për komisionin e vlerësimit të tenderit për kontratën me titull "Blerja e mjeteve specifike te punës për DPZH" me nr.02-749 të datës: 17.03.2026
- Vendim per formimin e komisionit për kontratën me titull "Montimi dhe servisimi i klimave të përdorura" me nr 02-673 te datës 11.03.2026.
- Vendim për formimin e komisionit për kontratën me titull "Blerja e licensave për programe profesionale AutoCAD" me nr 02-891 te datës 27.03.2026.
- Vendim për formimin e komisionit për kontratën me titull "Blerja e licensave për programe profesionale (AutoCad Civil 3D)" me nr 02-892 të datës 27.03.2026.
- **Komision mbikëqyrës** - me vendim nr. 02-3067 dt.31.07.2025, është caktuar komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: **"Renovimi i objektit të Drejtorisë – RITENDER"**, me nr. të prokurimit IL-25-4484-5-1-1, Nr. Protokoli 02-3050 i datës 30.07.2025. Menaxheri i projektit dhe OE ka nënshkruar PMK . Më dt. 04.09.2025 menaxheri i projektit ka dërguar Letrën për fillimin e punëve, me çrast OE ka filluar punët nga dt. 05.09.2025. Komisioni mbikëqyrës ka aprovuar punët sipas situacionit të I-rë, raporti i pjesshëm i punës, 02-4273 dt.18.11.2025. Komisioni mbikëqyrës ka aprovuar punët sipas situacionit të II-të, raporti i pjesshëm i punës, 02-4664 dt.24.12.2025. Gjatë këtij tre mujori janë inspektuar zhvillimet e punimeve sipas planit dinamik. Për inventarë kanë bërë përzgjedhjen e ngjyrave dhe teksturave. Kanë vazhduar punët në trajtimin e mureve, instalimet elektrike dhe IT, punët e instalimeve makinerike, instalimi i ngrohjes nën dysheme, sistemi ngrohje/ftohje VFR, klimatizimi, punët e keramikave dhe granitit, punët e dyerve dhe dritareve, punët e pllafonit të lëshuar etj. Kërkesa e Operatorit Ekonomik është aprovuar për punë shtesë dhe të paparapara dhe për zgjatjen e afatit për ekzekutimin e punimeve. Kontrata është në zhvillim.
- **Komision mbikëqyrës** - me nr. 02-628 dt.05.03.2026, është caktuar komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: **"Punë shtesë Renovimi i Objektit te Drejtorisë – RITENDER"**, me

nr. të prokurimit IL-26-328-5-2-5, Nr. Protokoli 02-608 i datës 05.03.2026. Menaxheri i projektit PMK dhe OE kanë nënshkruar kontratën. Më dt. 05.03.2026 menaxheri i projektit ka dërguar Letrën për fillimin e punëve, me atë rast OE ka filluar punët nga dt. 05.03.2025. Komisioni mbikëqyrës ka aprovuar punët sipas situacionit të I-rë, raporti i pjesshëm i punës, 02/1-719 dt.12.03.2026. Punët e ekzekutuara janë: demolimi i mureve ndarëse dhe mveshjeve prej paneleve të drurit, punimi i mureve ndarëse me knauf, mveshja e mureve me pllaka gipsi, punët e atikës në kulm, sanimi i thyerjeve ekzistuese sipërfaqësore të shtyllave, trajeve dhe pllakës, punët e granitit, punët e llamarinës, punët e instalimeve elektrike dhe makinerike. Komisioni mbikëqyrës ka aprovuar punët sipas situacionit të II-të, raporti përfundimtar i punës, 02/1-813 dt.24.03.2026. Punët e ekzekutuara janë: punimi i mveshjeve të shtyllave me pllaka gipsi, mveshja e mureve me pllaka gipsi, punët e instalimeve elektrike dhe makinerike. Kontrata ka përfunduar.

- **Komision mbikëqyrës** - me vendim nr. 02-4625 dt. 22.12.2025, për kontratën me titull: **"Angazhimi i një zyreje projektuese për studimin e sanimit të rrëshqitjeve – RITENDER"** me numër të prokurimit IL-25-4023-2-2-1, nr. protokoli 02-4577 i datës 18.12.2025. Me OE është organizuar vizita në terren me OE, për fillimin e matjeve gjeodezike dhe fillimin e realizimit të testimeve për hartimin e elaboratit gjeomekanik, hartimin e projektit kryesor për sanimin e rrëshqitjeve. Matjet gjeodezike dhe shpimet gjeoteknike janë përfunduar në Zupqe, Lushtë 1, Lushtë 2 si dhe Druar, ku janë marr mostra për analiza laboratorike dhe janë përfunduar të gjitha këto prova. Projekti është duke u hartuar. Kontrata është në zhvillim.
- **Komision mbikëqyrës** - SCADA projekti - nr. Protokollit 01-1227/1, me vendim të datës 13.06.2019. Projekt i Bankës Botërore, WSCP-G-ICB-2, që implementohet përmes kompanisë/konzorciumi: JV Inter-Adria dhe Oskar. Disa nga punët e planifikuara ende nuk janë përfunduar. Tek Kosova B nuk është montuar ende senzori i parashikuar në projekt. Gjithashtu, disa puseta, përfshirë ato tek Besia dhe Ferronikeli, shfaqin rrjedhje uji, për shkak të izolimit të pamjaftueshëm, gjë që ka rezultuar në mbushjen e tyre me ujë. Këto probleme kërkojnë ndërhyrje për të siguruar funksionimin korrekt dhe për të parandaluar dëmtime të mëtejshme.
- **Komision mbikëqyrës** - në projektin: **"Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve te IL-se për prodhimin e energjisë alternative Solare"**, - nr. Protokollit 02-1807, me vendim të datës 05.06.2025. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar të Projektit "Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve te IL-se për prodhimin e energjisë alternative Solare", i përfunduar më 17.12.2025 dhe i protokolluar më 18.12.2025 me nr. 08-4582, u paraqit nevoja për inicimin e kërkesës pranë KEDS-it për dhënien e pëlqimit parimor.

  Për këtë qëllim, më 14.01.2026 u realizua vizitë zyrtare në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku u verifikuan të dhënat kadastrale për parcelat në pronësi të N.H."Ibër-Lepenc". Pas kësaj, janë përgatitur dhe dorëzuar kërkesat për tri projektet, me planet e parcelave dhe kërkesat për lista poseduese në komunat Prishtinë dhe Çagllavicë. Gjatë shqyrtimit është konstatuar mospërputhje e një pjesë të konsiderueshme e numrave të parcelave nuk përputhen me numrat që figurojnë në regjistrat komunal çka kërkon verifikim dhe harmonizim të mëtejmë me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

- **Komision mbikëqyrës** – në kuadër të projektit "**Rindërtimi i segmenteve të Kanalit Besi-Graçankë – RITENDER**", komisioni mbikëqyrës ka zhvilluar takime me operatorin ekonomik dhe është përcjellë realizimi i punimeve. Kontrata është në zhvillim.
- **Komision vlerësimi** – sipas vendimit për komisionin e vlerësimit të tenderit me titull: "**Blerja e licencave për programe profesionale AutoCAD**", me nr. Prot. 02-432 dt.13.02.2026, më dt.13.02.2026 kanë filluar dhe përfunduar punët për vlerësimin e tenderit në fjalë.
- **Komision mbikëqyrës** - me vendim nr. 02-891 dt. 17.03.2026, është caktuar Komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: "**Blerja e Licencave për programe profesionale AutoCad**", me nr. te prokurimit IL-26-307-1-3-6, Nr. Protokoli 02-891 i datës 27.03.2026. Plani për menaxhimin e kontratës është nënshkruar.
- **Komision mbikëqyrës** - me vendim nr. 02-892 dt.27.03.2026, është caktuar Komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: "**Blerja e licensave për programe profesionale (AutoCad Civil 3D)**"", me nr. te prokurimit IL-26-346-1-2-1, Nr. Protokoli 02/868 i datës 26.03.2026. Plani për menaxhimin e kontratës është nënshkruar.
- **Komision vlerësimi** - sipas vendimit për Komisionin e vlerësimit të tenderit me titull: "**Montimi dhe servisimi i klimave të përdorura**", me nr. Identifikues: IL-26-226-2-3-6 dhe nr. Protokoli 02-370 të datës 09.02.2026, kanë filluar dhe përfunduar punët për vlerësimin e tenderit në fjalë.
- **Komision mbikëqyrës** - "**Montimi dhe servisimi i klimave të përdorura** ", me nr prokurimit IL-26-226-2-3-6 - nr. Protokollit 02-669, i datës 11.03.2026. Me të datës 11.03.2026, nr. Protokollit 02-673. Komisioni ka dalë në terren me datën 18.03.2026, për mbikëqyrje të punimeve gjatë montimit të klimave në Komoran dhe Shkabaj, me datën 25.03.2026, në Shkabaj dhe Mihaliq dhe me datën 27.03.2026 tek Diga Ujman. Kontrata është në zhvillim.
- **Komisioni për përgaditjen e draftit dhe plotësim ndryshimin e shenjave unike për klasifikim e dokumenteve dhe afateve të ruajtjes së tyre** - Komisioni për përgatitjen e draftit dhe plotësim-ndryshimin e shenjave unike për klasifikimin e dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre (nr. protokolli 02-4037, me vendim të datës 23.10.2025), është angazhuar në punët që lidhen me Arkivin e ndërmarrjes "Ibër-Lepenc".

  Puna është zhvilluar në përputhje me Listën e Klasifikimit të Dokumenteve të ndërmarrjes dhe Rregulloren e MPB-së, me qëllim përgatitjen e draftit final për tërë ndërmarrjen. Në bashkëpunim me kryetarit të Komisionit Qendror, është hartuar Lista me Shenja Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre.

  Për këtë qëllim, më 21.01.2026 u mbajt takim me përfaqësues të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, për shqyrtimin, plotësimin dhe harmonizimin e listës para miratimit dhe zbatimit të saj.
- **Komision vlerësimi** - për tenderin: "**Ndërrimi i tabelave komanduese në SP Samadregjë (Furnizim, montim dhe instalim)**" IL-26-571-1-2-1, i brendshëm IL-26-016-1-2-1. Me vendim nr.02-748, dt.17.03.2026, është caktuar komisioni dhe më dt. 17.03.2026, janë zhvilluar punët për vlerësimin e tenderit në fjalë.

- **Komisioni i vlerësimit** - për tenderin: "**Rehabilitimi i pompave në SP Samadregjë**". IL—26-562-2-2-1, i brendshëm IL-26-014-2-2-1. Me nr. 02-787, dt.19.03.2026, është caktuar komisioni dhe më dt. 19.03.2026, janë zhvilluar punët për vlerësimin e tenderit në fjalë.
- **Komision velerësimi** - me vendim nr. 02-749 dt. 17.03.2026, është caktuar komisioni për vlerësim të tenderit **"Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH"**.
- **Komisioni vlerësimi**– për tenderin – **"Furnizim me material zyrtar"**.
- Sipas Planit të biznesit 2026: **Renovimi i stacioneve Pompike** (revidimi pas kërkesave të reja nga shefat e njësive të departamentit të ujitjes): Samadrexhë, Pantinë, Fushticë, Gjurashin, Korroticë, Krashticë (Gllobar) ku, Sipas planit te veprimit të DPZH-së(dhe planit te Biznesit) dorëzimi I revidimit të projektit ishte i paraparë me dt.20.05.2026, është perfunduar me datë 31.03.2026 pra janë kompletuar specifikimet teknike për projektin që përfshinë renovimin e gjashtë stacioneve pompike.
- **Komision profesional** – me vendim me nr. Identifikues 02-4105 të datës 30.10.2025 është caktuar Komisioni profesional për shqyrtim të kërkesës nga "Safari-Group". Me datë 09.01.2026 komisioni zyrtarisht i është përgjigjur kompanisë në fjalë.
- **Komision profesional** – me vendim nr. Identifikues 02-4487 të datës 09.01.2026 është caktuar Komisioni profesional për shqyrtimin e kërkesës nga "IPE-Proing". Me datë 09.01.2026 komisioni zyrtarisht i është përgjigjur kompanisë në fjalë.
- **Komision profesional** – me vendim nr. identifikues 02-552 të datës 27-02-2026 është caktuar komisioni për shqyrtim të kërkesës për shqyrtimin e punëve shtesë për renovimin të objektit të drejtorisë – RITENDER, të identifikuara nga organi mbikeqyrës. Komisioni ka kryer veprim të ndërmjetëm duke bërë analizën e çmimeve të tregut.
- **Komision profesional** – me vendim nr. Identifikues 02-548 të datës 26.02.2026 është caktuar komisioni për analizat dhe hartimin e projektit për plotësimin e nevojave të projektit paraprak të zhvilluar nga WSCPP për rehabilitim të kanalit.
- **Trajnim** – me datë 16/01/2026 nga stafi i DPZH-se kanë marr pjesë në workshop në kuadër të trajnimit mbi sigurinë e digave (të ogranizuar nga FLOWS and WB me kompaninë italiane Pietrangeli technical Assistance on Dam Safty Assessment and Management". Më datë 27/01/2026 dhe 10/02/2026 është mbajtur sesioni online.
- **Trajnim i stafit** – një pjesë e stafit të DPZH-se kanë vijuar trajnimin **„Menaxhimi i kontratës përmes e-prokurimit "**, i cili është mbajtur me datë 23 dhe 24 mars 2026.
- **Workshop** – me datat 27,28,29/03/2026 zyrtari nga ky departament ka marr pjesë në workshop-in për hartimin e rregullores për ura. E njëjta rregullore duhet të plotësohet edhe me ura metalike në ditët në vijim.
- Inspektim i punimeve në terren për kontratat mbikëqyrëse.
- Hartimi dhe dorëzimi i specifikave teknike me dt.26.01.2026, për "Montimin dhe servisimin e klimave të përdorura", sipas Planit të biznesit 2026.
- Hartimi dhe dorëzimi i specifikave teknike me dt. 30.01.2026, për "Blerjen e Licensave për Programe profesionale (AutoCad), sipas Planit të biznesit 2026.

- Hartimi dhe dorëzimi i specifikave teknike më dt.02.02.2026, për projektin: "Blerja e Licencave për Programe profesionale (Autocad Civil 3D- pako)", sipas Planit të biznesit 2026.
- **Kontrata për qiranë e objektit** është vazhduar dhe njëkohësisht është kryer pagesa në vlerë prej 11,978.02 euro.
- Plani i veprimit – përgatitja e planit të veprimit të aktiviteteve të shërbimeve të DPZH-së, për vitin 2026, sipas Planit të Biznesit 2026.
- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme nga punëtorët e DPZH-së sipas vendimit.

## 2.7. Njësia zbatuese e projektit WSCP

Aktivitetet në kuadër Projektit të Bankës Botërore të raportuara gjatë tremujorit të parë për 2026 (TM1) janë pasqyruar si në vazhdim :

| | |
|---|---|
| NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.<br>HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.<br>VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D. | |
| **Projekti me Bankën Botërore** | |
| **RAPORTI TREMUJOR (TM1_2026)** | |
| **Emri i Kontratës:** | **Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit - WSCP** |
| **Investitori** | **N.H. "Ibër -Lepenc" Sh.A Prishtinë** |
| **Nën-projektet** | **1.Rehabilitimi i kanalit kryesor të „Ibër -Lepencit"**<br>**2.Konsulenca**<br>**3.SCADA** |
| **1. Emri i Projektit** | **Rehabilitimi i kanalit kryesor të „Ibër- Lepencit"** |
| **Kontraktori** | **"Famis.CO and Kit AK Gradnje"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **24/05/2023** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **12,875,191.63 €** |

| | |
|---|---|
| **2. Emri i Projektit** | **Konsulenca – Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor** |
| **Kontraktori** | **"IPE Proing Sh.P.K"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **08/06/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **270,700.00 €** |
| **3. Emri i Projektit** | **Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA** |
| **Kontraktori:** | **JV Interadira & OSKAR-EL** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **21/05/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **1,072,044.24 €** |
| **Vlera e punimeve të kryera:** | **899,923.20 €** |

**Periudha Raportuese: 01.10.2026 - 31.3.2026**

Gjatë periudhës Janar – Mars, kontraktori ka zhvilluar aktivitete ndërtimore në zonën e punimeve në Zubin Potok në Segmentin B7 me gjatësi L-405 m. Punimet në këtë segment kanë filluar në mes të nëntorit 2024, me hapjen (gërmimin) e rrugës së qasjes, mirëpo punimet janë pezulluar për arsye sigurie në këtë zonë.

Gjatë periudhës së pezullimit, rrjedhja e vazhdueshme nga një gyp i kanalizimit i instaluar nga një palë e tretë ka shkaktuar shembje të dheut mbi bypass-in anësor të instaluar më parë nga Kontraktori. Kjo ka bërë të domosdoshme përdorimin e makinerisë së rëndë për të larguar dheun e shembur dhe për të rivendosur funksionalitetin e bypass-it.

Në muajin Shkurt - Mars kontraktori ka punuar me intezitet te larte per te perfunduar punimet ne gjatesin e kanalit per te perfunduar te gjithe kanalin deri me date 31 Prill siq eshte i parapare.

**Aktivitetet e punës dhe raportimi i tyre**

**Punimet e rehabilitimit dhe riparimit përfshijnë si më poshtë:**

1. Rindërtimi i pjesëve të hapura të të kanalit trapezoid dhe drejtkëndësh me Beton (gjatësia totale përafërsisht 9,194.70 m në gjithsej 55 seksione, në komunat: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, dhe Obiliq), duke ruajtur rrjedhën e panderprerë të Ujit.

2. Zëvendësimi i kanalit të hapur pranë fshatit Zubin Potok me elemente nga betoni dhe mbulesë të kanalit (gjatësia përafërsisht 405 m).

3. Ndërtimi i sektorit të dytë 2 të Rezervuarit Bufer me gjatësi 800 m dhe gjerësi 8m' .

4. Riparimi i Akuadukteve me gjatësi 24600.23m2, riparimi Ii sipërfaqes së brendshme të akuadukteve duke riparuar vrimat dhe aplikimin e materialit hidroizolues si shtresë e sipërme duke përfshirë trajtimin e fugave sipas Specifikimit Teknik dhe kërkesave të furnizuesit.

Numri i akuadukteve është 17 copë me gjatësi totale përafërsisht. 1,989,264.01m në komunat Zubin Potok 7, Mitrovicë 2 dhe Vushtrri 8.

5. Punime të tjera

Ndërtimi i murit mbrojtës 318 m'

Pastrimi dhe rivendosja e 41 lëshesave ekzistuese dhe ndërtimi i 10 kanaleve të reja

Ndërtimi i 21 kutive të shpërndarjes së ujit (dhoma betoni nëntokësore direkt në buzë të kanalit me marrjen e ujit nga kanali)

Instalimi i 13 rrjetave metalike në kalimine kanalit nga seksionet e kanalit të hapur në atë nëntokësor.

Punimi i gropave septike (pellgje betoni nëntokësor, 4 x 8,000L), për lidhje me shtëpitë afër kanalit.

6. Çështjet mjedisore

Ekzekutimi i punimeve të riparimit dhe rehabilitimit duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIAF), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF), Kornizën e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), politikat dhe procedurat e Bankës Botërore, si dhe legjislacioni.

- Kontraktori "JV Famis Co dhe Kit AK Gradnje"
  Vazhdimi i punimeve në kanalin kryesor

Pas nënshkrimit të kontratës me datën 24.05.2023, kontraktori "Famis Co dhe Kit AK Gradnje" kanë paraqitur Planin Dinamik të mobilizimit në teren dhe kanë filluar punët sipas kushteve të kontratës FIDIC, ku bazohet projekti "Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit".

Gjatë kësaj periudhe të raportimit kontraktori ka punuar me disa pozicione të punimeve:

**Kanali Trapezoidal**

Deri më tani, Kontraktori ka përfunduar **7 segmente**

Deri në këtë fazë, Kontraktori ka arritur progres në segmentet e mëposhtme:

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A2.1 | Km 16+540.00 | Km 16+864.27 | L= 324.27m | 100.00% |
| 2 | A3.6 | Km 27+138.37 | Km 27+591.20 | L=452.83m | 100.00% |
| 3 | A4.2 | Km 29+725.46 | Km 31+190.89 | L=1,465.43m | 100.00% |
| 4 | A6.1 | Km 36+147.52 | Km 36+517.89 | L= 370.37m | 100.00% |
| 5 | A6.2 | Km 36+631.37 | Km 36+733 | L= 101.20m | 100.00% |
| 6 | A7.2 | Km 42+266.03 | Km 42+527.60 | L=261.57m | 100.00% |
| 7 | A7.4 | Km 45+704.08 | Km 46+405.13 | L=701.05m | 100.00% |
| | | | Total: | 3,676.65 m | 100.00% |

**Rehabilitimi i Akuadukteve**

Kontraktori ka përfunduar rehabilitimin e 16 segmenteve të akuedukteve. Duke arritur një progres prej afërsisht 96.42% në rehabilitimin e tyre ose duke përfunduar 2,053.70 metra nga gjithsej 2,129.89 metra

| No | PAK | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PAK1.1 | Km 04+305.01 | Km 04+369.35 | L=64.34 m' | 100.00% |
| 2 | PAK1.2 | Km 05+054.00 | Km 05+126.55 | L=72.55 m' | 100.00% |
| 3 | PAK1.3 | Km 07+529.57 | Km 07+586.89 | L=57.32 m' | 100.00% |
| 4 | PAK1.4 | Km 08+542.73 | Km 08+620.00 | L=77.27 m' | 100.00% |
| 5 | PAK1.5 | Km 09+170.86 | Km 09+344.39 | L=173.53 m' | 100.00% |
| 6 | PAK1.6 | Km 09+738.08 | Km 09+817.92 | L=79.84 m' | 100.00% |
| 7 | PAK1.7 | Km 11+078.87 | Km 11+114.64 | L=35.77 m' | 0.00% |
| 8 | PAK1.8 | Km 12+497.55 | Km 12+497.55 | L=162.45 m' | 100.00% |
| 9 | PAK2.1 | Km 19+632.40 | Km 19+799.26 | L=166.86 m' | 100.00% |
| 10 | PAK2.2 | Km 20+085.68 | Km 20+417.58 | L=331.90 m' | 100.00% |
| 11 | PAK2.3 | Km 23+894.68 | Km 24+033.93 | L=139.25 m' | 100.00% |
| 12 | PAK2.4 | Km 24+894.78 | Km 25+080.39 | L=185.61 m' | 100.00% |
| 13 | PAK2.5 | Km 26+111.90 | Km 26+188.67 | L=76.77 m' | 100.00% |
| 14 | PAK2.6 | Km 27+011.97 | Km 27+138.37 | L=126.40 m' | 100.00% |
| 15 | PAK3.3 | Km 34+934.73 | Km 34+975.15 | L=40.42 m' | 0.00% |
| 16 | PAK3.5 | Km 36+517.87 | Km 36+631.37 | L=113.50 m' | 100.00% |
| 17 | PAK4.1 | Km 42+635.09 | Km 42+760.74 | L=125.65 m' | 100.00% |
| 18 | E2A.1 | Km 45+603.62 | Km 45+704.08 | L=100.46 m' | 100.00% |
| | | | Total: | L=2,129.89 m' | 100.00% |

**Kanalet drejtkëndëshe**

Më 18 shkurt 2024, Kontraktori ka filluar realizimin e bypass-it, përmes kanalit anësor, në segmentin B10A.15, nga Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47, dhe ka vazhduar me segmentet e tjera për kanalin e tipit drejtkëndor.

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B10A.15 | Km 47+280.00 | Km 47+364.47 | L=84.47m | 100% |
| 2 | B10A.16 | Km 47+551.50 | Km 47+620.00 | L=68.50m | 100% |
| 3 | B10A.17 | Km 47+738.54 | Km 47+869.05 | L=130.51m | 100% |
| 4 | B10A.18 | Km 48+113.12 | Km 48+378.81 | L=265.69m | 100% |
| 5 | B10A.19 | Km 48+428.80 | Km 48+496.00 | L=67.20m | 100% |
| 6 | B10A.19' | Km 48+604.75 | Km 48+684.59 | L=79.84m | 100% |
| 7 | B10A.20 | Km 48+854.91 | Km 49+191.00 | L=336.09m | 100% |
| | | | Total: | 1,032.30 | 100% |

**Seksioni i kanalit drejtkëndësh i mbyllur – L = 405.38m**

Punimet në këtë segment kanë filluar në mes të muajit nëntor 2024, me gërmimin e rrugës së qasjes. Kontraktori është duke punuar me intensitet të lartë në këtë segment, me qëllim që punimet të përfundojnë brenda afatit kohor të paraparë sipas kushteve të kontratës.

bypass-it.

**Rehabilitimi i kanalit në përqindje (%)**

| Bill No. A2 - Canal Rehabilitation | length | segments | Progress | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | m' | pcs. | length | | number | percentage |
| Canal section for trapezoidal canal type | 3,676.72 | 7 | 3,676.65 | m | 7 | 100.00% |
| Canal section for rectangular open type | 1,032.30 | 7 | 1,032.30 | m | 7 | 100.00% |
| Canal section rectangular closed | 405.38 | 1 | 405.38 | m | 1 | 100.00% |
| Rehabilitation of Aqueduct | 2,053.70 | 16 | 2,053.70 | m | 15 | 100.00% |

**Puseta BA për SCADA**

Kontraktori është në përfundim të ndërtimit të pusetës për sistemin Scada tek përfundimi i kanalit afër Kosova – B. Ka mbetur vetëm instalimi i Ujëmatsave dhe përfundimi i punëve të izolimit.

**Në vazhdim janë paraqitur disa foto të punimeve në terren:**




